Lloji	Baza e taksës	Norma	Shuma	MP
CO	417.660	0.000	0.00	1
VT	417.660	18.000	75.18	1
Totali			75.18	1

48 Llogaria e pagesës | 49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISË

Mënyra e pagesës	KESH		
Numri i Pranimit	L 12453	Data	09/06/2018
Numri Pagesës	P 8325	Data	09/06/2018
Garancioni	0.00	EUR - Data	
Totali shtrëmbimeve	0.00	EUR	
Totali taksave	2,782.74	EUR	

50 Principali Nr Nënshkri

C ZYRA E NISJES

51 Zyra zyrë e tranzitit vendi
Përfaqësuesi ngjk.
Vendi dha data:

52 Garancioni i | Kodi | 53 Zyra e destinacionit dha vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT Vula: | 54 Vendi dhe data

Deklaruesi emri / përfaqësuesi
DRITON BYTYQI

Nënshkri

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PRO SHPED FERIZAJ

Asycuda World

Manifesti	2018 8763	1 DEKLARATE	
Referenca doganore	R 12469 09/05/2018	IM 4 —	ZYRA E DESTINIMIT
7 Numri refeftues	2018 #485	3 Formularët 3 3	2060 ZBD FERIZAJ

31 Paketimi dhe. përshkrimi i mallit

Shenjat dhe numrat - Nr i kontenierit - Numri dhe lloji

Shenja & nr

I pakove

Nr. dhe 0 NG

Pa paketim

Makineria me rrotullim të superstrukturës 360°, eskavatorët track - laying

Mini Eskavator me zingjir goma
Micro Excavator Marka:Tack Tipi:XN08
Nr.Serik:17C070788 Viti:2017

32 Artikulli 5 Nr

33 Numri tarifor 84295210 00

34 Kodi origjinës a CN b

35 Pesha bruto (kg) 880.00

36 Preferenca

37 Procedura 4000 000

38 Pesha Neto (kg) 880.00

39 Kuota

40 Dokumenti paraprakisht/dok. përmbledhës S/L 1

41 Njësia plotësuese PCE 1.00 6,655.00

43 M.V. 1 kodi

44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime

Nr. Licencës D.Vle D.Sas

443.39+0.00+0.00+15.70-1,147.51

D.SH. 380 934

Kodi LSH 1.000

46 Vlera Statistikore 5,966.58

31 Paketimi dhe. përshkrimi i mallit

Shenjat dhe numrat - Nr i kontenierit - Numri dhe lloji

Shenja & nr

I pakove

Nr. dhe Lloji 0 NG

Pa paketim

Mjete ngritese pirun me motor jo elektrik, me një lartësi ngritjeje 1 m apo

Pirunjor i perdorur:-
Marka:Fiat Tipi:D30 Nr.Serik:5141510351
Viti:1996

32 Artikulli 6 Nr

33 Numri tarifor 84272011 00

34 Kodi origjinës a IT b

35 Pesha bruto (kg) 3,000.00

36 Preferenca

37 Procedura 4000 000

38 Pesha Neto (kg) 3,000.00

39 Kuota

40 Dokumenti paraprakisht/dok. përmbledhës S/L 1

41 Njësia plotësuese PCE 1.00 2,994.75

43 M.V. 1 kodi

44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime

Nr. Licencës D.Vle. D.Sas

199.53+0.00+0.00+7.06-516.38

D.SH. 380 934

Kodi LSH 1.000

46 Vlera Statistikore 2,684.96

31 Paketimi dhe. përshkrimi i mallit

Shenjat dhe numrat - Nr i kontenierit - Numri dhe lloji

Shenja & nr

I pakove

Nr. dhe 0 NG

Pa paketim

Grup gjeneratorët me motor diesel, me dalje jo më tepër se 7.5 kVA

Gjenerator i perdorur:-
AKSA AAP6000DE VITI:2014
6.6kw

32 Artikulli 7 Nr

33 Numri tarifor 85021120 90

34 Kodi origjinës a DE b

35 Pesha bruto (kg) 100.00

36 Preferenca

37 Procedura 4000 000

38 Pesha Neto (kg) 100.00

39 Kuota

40 Dokumenti paraprakisht/dok. përmbledhës S/L 1

41 Njësia plotësuese PCE 1.00 110.00

43 M.V. 6 kodi

44 Inf. shtesë Dokumente Certifikata dhe Autorizime

Nr. Licencës D.Vle. D.Sas

7.33+0.00+0.00+0.26-18.97

D.SH. 380 934

Kodi LSH 1.724

46 Vlera Statistikore 170.02

47 Llog. taksave taksat

Lloji	Baza e taksës	Norma	Shuma	MP
CD	5,966.580	0.000	0.00	1
VT	5,966.580	18.000	1,073.98	1
Totali emërt. parë			1,073.98	

Lloji	Baza e taksës	Norma	Shuma	MP
CD	2,684.960	0.000	0.00	1
VT	2,684.960	18.000	483.29	1
Totali emërt. dytë			483.29	

Lloji	Baza e taksës	Norma	Shuma	MP
CD	170.020	10.000	17.00	1
VT	187.020	18.000	33.66	1
Totali emërt. tretë			50.66	

Lloji	Shuma
CD	25.60
VT	2,757.14
Totali	2,782.74

Eskavatori

„Berisha Company"sh.a
Adresa: Magistrala
Qyteti: Ferizaj
NRB: 70089594
Nr. Fiskal: 600241913

NUI: 70037671
NIF: 900033857
Xh.llog: 20130000164760 69 - TEB

FATURË Nr. 15-7/2018

Datë: 30.07.2018

Lënda: Kërkesë për pagesë

Shitblerja e ESKAVATORIT

Nr.	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi gjithsej €
1	Marka: TACK Tipi: XN08 Viti prodhimit: 2017 Numri serik: 17C050788	copë	1.00	5.996.0000	5.996.00 €
			Gjithsej		5,996.00 €
			TVSH 18%		1,079.28 €
			Gjith me TVSH		7,075.28 €

Vërejte:
Pagesa e faturës duhet te bëhet mbrenda 28 ditësh.

Departamenti i Shitjes:

Aprovoi Klienti:

Company „Eskavatori" sh.p.k
Magistrala Ferizaj-Prishtinë p.n. • 70000 • Ferizaj RKS
• Tel: 00383 49 100 581, 328 49 00 534
E-mail: eskavatori@hotmail.com, eskavatoricompany@gmail.com

BKT Kosova

BANKA KOMERCIALE TRETIARE

e-Mandati

DATA : 13.08.2018

BERISHA COMPANY SHA

Adresa : MAGJ FERIZAJ PRISHTINE FERIZAJ 70000 null

Detajet e Veprimit

Numri Kompanise	:	740295887
Llogaria Debituese	:	1940295887031109
Numri Referencës	:	740EICS182250015
Data Veprimit	:	14.08.2018
Informacion mbi Detyrimet	:	N/A
Llogaria Kredituese	:	XK051703200003007977
Emri i Përfituesit	:	ESKAVATORI SHPK
Shuma Debituar	:	100,225.07 EUR
Shuma Kredituar	:	100,225.07 EUR
Përshkrimi	:	Pagese per makineri fat nr15-7/2018,14-7/2018,13-7/20188-7/2018 16-7/2018,11-7/2018
Kursi Këmbimit	:	1.00

Detajet e Detyrimeve

Përshkrimi	Shuma	Data
No Charges		

Shenim: Ky mandat elektronik ka vetem qëllim informues dhe nuk sherben si dokument i autorizuar. Në rast se informacioni nuk perputhet, ne konsiderata merren te dhenat e bankes. Merrni prane degeve te BKT-se nje kopje te autorizuar te transakcioneve.

Data Krijimit: 21.12.2022 13:53:32

Pretendimi nr 5

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Lipjan ne fazen e vleresimit te ofertave ka bere shkelje te neni 59 dhe 69 Te LPP-se perveq diskriminimit te kompanise tone te cilen ka bere, AK ka rekomanduar per kontrate nje GOE te papergjegjshem i cili nuk ploteson kerkesat e dosjes se tenderit sepse GOE i rekomanduar per kontrate prezantuar nje DUD DOGANOR per paisjen **Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5T"** te nje kompanie tjeter dhe numri unik identifikues nuk eshte i njejti me pronesin e tij dhe te fituesit.*(Dokument i siguruar ne pergjigjjen e kerkeses per rishqyrtim te nje OE tjeter te ketij aktiviteti te prokurimit). Kjo paraqet nje dyshim se eshte nje dokument i falsifikuar.*

Sa per Sqarim GOE i rekomanduar per kontrate është BEGISHOLLI COMPANY me NUI 810134627 ndersa Dudi doganor i prezantuar N.T.P Begisholli me NUI. 810638463, ku kemi dy kompani te ndryshme e cila eshte marrur si nje dokument i pronesis se GOE i rekomanduar per kontrate.

Pas hulumtimeve me te detajuara kemi te bej me shkelje edhe me te medha ku perveq se ky Dud Doganore nuk eshte ne pronesi te GOE te rekomanduar per kontrate, pershkrimi i paisjes ne Dudin Doganor korrospodon me peshe tjeter te peshes reale, qka dyshohet per **manipulim ose falsifikim**.

Paisja sipas Dudit Doganor **"Pjese per Eskavator VTC 50 e vitit 1996 Gersher per demolim betoni dhe prerese e armatures"** sipas specifikacionit ka keto karakteristika :

VTC 50 Buy & Rent Spare parts Transport Events & News

1996–2005

Specification Accessories

Specification

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Operating weight	3.4 t	Carrying device	30-42
Opening	975 mm	Cutting force	2500 kN
Total width	2650 mm	Model series	VTC

More technical details, like: wrench opening depth, total length are available in the full technical specs.

Basic model without hoselines and adapter for excavator

Special equipment

- endless rotation
- Piston rod protections
- Quick hitch mech.

Sipas emertimit paisja ka peshe 3.4ton ndersa ne Dudin e prezantuar ka peshen të rrumbullaksuar prej 5ton, si e tille kjo pasije nuk e ploteson kerkesen sipas dosjes se tenderit nga AK, e njejta ka mundur te verifikohet edhe nga AK gjate fazes se vlersimit mirpo verehet qarte tendenca per **FAVORIZIM**.

Ne baze te pretendimeve te lartecekura kerkojme nga OSHP qe te merr nje vendim

VENDIM

- **APROVOHET** si e bazuar ankesa e grupit te GOE "NOI CONSTRUCTION SHPK & CONSTRUCTION GROUP SHPK"
- **ANULOHET** Njoftimi dhe Vendimi i AK ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit dhe lënda të kthehet ne **RIVLERSIM.**
- **TE DETYROHET** autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, dhe konform dispozitave ligjore të LPP-së

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit Të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim

Fitimi i humbur nuk eshte llogaritur ne kete faze

10. **Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura:**

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *Njoftimi per kontrate 19.02.2025*
- *Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 27.02.2025*
- *Dorezimi dhe hapja e tenderit 12.03.2025 14:00*
- *Njoftim mbi vendimi e AK 28.03.2025*
- *Leter standarde per tenderuesin e eleminuar 28.03.2025*
- *Kerkese per qasje ne dokumenta 28.03.2025*
- *Kerkese per rishqyrtim 02.04.2025*
- *Pergjigjje ndaj kerkeses per rishqyrtim 04.04.2025*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinali ne ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OFLIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 04.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 02.04.2025 të parashtruar nga **OE Noi Construction shpk, Lipjan, per aktivitetin e prokurimit me titull:** Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan **me nr të prokurimit: 613-25-851-5-2-1**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim OE **Noi Construction shpk, Lipjan, per aktivitetin e prokurimit me titull:** Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan **me nr të prokurimit: 613-25-851-5-2-1**

Vërtetohet Vendimi i AK i publikuara ne platformen e prokurimi i dates: 28.03.2025, i propozuar per kontrate **OE** Grup i Operatorëve Ekonomik BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K.; R & Rukolli Ferizaj

1. **Mbetet në fuqi Vendimi i AK i publikuar ne Platformen e Prokurimi** i dates: 28.03.2025

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

A r s y e t i m

Sqarim lidhur me qasjen tuaj:

Autoritet Kontraktues duke ju referuar nenit 68 dhe 69, lidhur me nrnin 7, te Ligjit per Prokurim Publik **i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**
(Versioni i Konsoliduar), nenit 7 te Rregullores per Prokurim Publik 001/2022, versioni i konsoliduar 11.11.2024, interpretimit te dt:24.10.2023, pytja e 31 te publikuar nga KRPP, i ka ofruar qasjen ne versionin e pastruar.
Pasi qe OE ka plotesuar kushtet, sipas LPP-se, legjislacion baze dhe i veçant per Prokurim Publik.

Sic vijon:

Autoritet Kotraktues i ka lejuar qasjen sipas LPP-se, në Ofertën OE "BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K."." me rastin e ofertimit ka plotësuar aneksin 3 të DT përmes të cilit ka kërkuar nga AK – KUVENDI KOMUNAL LIPJAN, që informatat dhe dëshmitë sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji të klasifikohen dhe mbesin si sekret afarist për të gjitha palët duke përjashtuar palët e përcaktuara të nenit 7.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Sipas kërkesës në fjalë OE "BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K." ka kërkuar mbrojtjen e konfidencialitetit komercial me arsyetimin se informacionet apo dokumentet në fjalë nuk kanë të bëjnë me dokumente publike, dhe se vënja e tyre në dispozicion për OE konkurrent apo palët tjera, si dhe zbulimi i qëllimshëm apo nga pakujdesia do të rezultonte me dëmtim material dhe jo material të interesave komerciale legjitime të afarizmit të tij.

AK konsideron se në ketë çështje ka vepruar në përputhje me të gjitha kërkesat e dispozitave ligjore për promovimin e transparencës sipas nenit 10 dhe 11 të LPP- së lidhur me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik si dhe në përputhje me rregullat e përgjithshme administrative sipas nenit 5 dhe 9 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Interpretimit te dt:24.10.2023, pytja e 31 te publikuar nga KRPP, i ka ofruar qasjen ne versionin e pastruar. Në mes të tjerash citoj

"7.3 Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuara nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente"

Përgjigje për pretendimin tuaj te Parë:

Kerkese e AK pika a) ka qene Min Nje inxhinier i ndertimtarise sistemi 5 vjeqar ose (master) drejtimi konstruktiv min 5 vite pervoje pune pas diplomimit,
Gjate kontrollimit te dokumentacionit tuaj ju keni vendosur dokumentacion per inxhinierin tuaj por tek diploma e tij eshte verejtur qe Diploma eshte mbrojtur me date 9 Mars 2022 dhe kjo nuk eshte 5 vite pervoj pune pas Diplomimit siq eshte kerkuar nga AK

Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar

Përgjigje për pretendimin tuaj te Dytë:

Tek Deshmia 2 eshte kerkuar: Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes, ose parakontratat e punes me validitet dhe kohesgjatje te kete projekti.
E drejte e AK eshte te paraqes kerkesen per nje dokument te caktuar dhe ne kete rast secili punedhenes duhet te dij qe nje kontrate e punes element baze ka kohen e fillim/mbarimit, pagen dhe elemente tjera qe percakton ligji i punes e jo AK.
Tek dokumentacioni juaj eshte verejtur qe nuk i keni te gjtiha kontratat e punes per stafin tuaj poahtu edhe te ato kontrata dhe parakontrata qe keni bashkangjitur jane te mangeta ne baze te ligjit te punes ju mungojne fillim/mbarimi dhe paga baze duke u bazuar ne ligjin Nr. 03/L-212, te nenit 10 dhe 11 po te ketij ligji. *Shtojce ligji i punes:*

Neni 10
Kontrata e Punës

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.

2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:

   2.1. një periudhë të pacaktuar;

   2.2. një periudhë të caktuar;dhe

   2.3. për punë dhe detyra specifike.

3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar.

4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindenjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

8. Të punësuarit për një punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e Punës.

9. Me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, përcaktohet koha në rastet kur me të punësuarin mund të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar dhe punë specifike, në pajtim me këtë ligj.

Neni 11
Përmbajtja e Kontratës së Punës

1. Kontrata e Punës përmban;

1.1. të dhënat për punëdhënësin (emërtimi, selia dhe numrin e regjistrimit të biznesit);

1.2. të dhënat për të punësuarin (emri, mbiemri, kualifikimi dhe vendbanimi);

1.3. emërtimin, natyrën, llojin e punës, llojin shërbimeve dhe përshkrimin e detyrave të punës;

1.4. vendin e punës dhe njoftimin që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme,

1.5. orët dhe orarin e punës;

1.6. datën e fillimit të punës;

1.7. kohëzgjatjen e Kontratës së Punës;

1.8. lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër,

1.9. kohëzgjatjen e pushimeve;

1.10. përfundimin e marrëdhënies së Punës;

1.11. të dhëna të tjera për të cilat punëdhënësi dhe punëmarrësi i vlerësojnë të rëndësishme për rregullimin e marrëdhënies së punës;

1.12. kontrata e Punës mund të përmbajë të drejta dhe detyra të tjera të parashikuara me këtë ligj;

1.13. të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me Kontratën e Punës, rregullohen me dispozitat e këtij ligji, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit;

2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për nevojat e punëdhënësve do të përgatisë mostra të kontratave të punës sipas standardeve minimale, për periudhë të pacaktuar, të caktuar dhe për punë specifike.

<u>Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar</u>

<u>Përgjigje për pretendimin tuaj te Tretë:</u>

Tek kerkesa 3, pika l) eshte kerkuar Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T =(min 1 cope)

Sqarim: Ne dokumentacionin tuaj kemi hasur ne nje dokument eskavator me zingjir tipi: 735 II LS dhe ne kete dude eshte edhe nje faqe shtese qe ka nje perberje shtese te mjeteve te punes: Luge per pastrim te lumejve, luge per germim 2 copa, qekan hidraulik, kran hidraulik dhe gersher per demolim, pasi qe ju skeni pasur nje dokument te veqant per kete kerkese sipas pikes l).

Poashtu ne kemi shikuar lidhur me kete eskavator se qfar specifikimi mund te kete dhe gjate evidentimit duke u bazuar ne te dhenat sipas dudit eskavator Furukawa tipi 735 II LS perket 18.9T, por ne kete dude jane edhe disa paisje tjera shtese qe kane peshe/tonazh te larte siq jane:

1.Luge per pastrim te lumejve 1 cope,
2.luge per germim 2 copa,
3.qekan hidraulik 1 cope,
4.kran hidraulik 1 cope dhe
5.gersher per demolim 1 cope,

Eskavatori ne dud doganor me te gjitha keto paisje jane 24,500 kg apo 24.5T, eskavatori ne baze te specifikimit sipas ketij tipi dhe nr eshte 18,900 kg apo 18.9 T, duke u bazuar ne kg e mbetura jane dhe 5600 kg apo 5.6T, qe nese ndahen per secilen paisje eshte 933 kg per secilen dhe ky DUD doganor nuk ka dokumente shtese dhe si deshmi e dorzuar nga ana juaj nuk ploteson kerkesen e AK-se dhe ju njofotjme qe AK nuk mund te marr per baze nje dokument te tille sepse eshte jashte kerkeses se AK-se. Poashtu nuk eshte mundur te kerkohet sqarim shtese sepse ju keni ofruar deshmi e cila nuk eshte plotesuar.

Specifikimi per eskavatorin sipas te dhenave te ketij dudi doganor:

Technical specs - 735 LS-tronic Furukawa

Specification | Accessories | Datasheets

Specification

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Weight	**18.9 t**	Transport length	**9.5 m**
Transport width	**2.86 m**	Transport height	**2.95 m**
Bucket capacity	**0.8 m³**	Track width	**600 mm**
Model series	**LS**	Engine manuf.	**Furukawa**
Engine type	**F 659 T**	Engine power	**90 kW**

More technical details, like: bucket capacity min., bucket capacity max., undercarriage, boom, max. reach horizontal, dredging depth, tear-out force, bucket width, dimension lxwxh, displacement, revolutions at max torque, max. torque, no. of cylinders, cylinder bore x stroke, emission level are available in the full technical specs.

Show less

Basic model incl. ROPS cabin, traction drive, standard boom and standard bucket

Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar

Përgjigje për pretendimin tuaj te katër:
Tek kerkesa 3, pika h) Eskavator max 1 T, ju keni dorzuar nje dud doganor i cili nuk ka permbajtje se kujna i perket ky dokument dhe nuk mund te mirret per baze nje dokument i tille, pa te dhenat e pronarit dhe sikur ju nuk do te kishit vendosur asnje dokument per kete paisje ne si AK do ju kerkonim sqarime shtese, por ju keni ofruar deshmi te cilat nuk permbushin kerkesen dhe deshmite e kerkuara nga AK
Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar

Ne rast se ju si OE do i perkisni keto dokumente qe nuk i keni vendosur ne oferten gjate aplikimit ju do ti ngarkonit ne kete kerkese per rishqyrtim por keto jane deshmi qe nuk mund te plotesohen dhe per te njejtat nuk mund te kerkohet sqarim shtese.

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP,
Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.
Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Data: 04.04.2025

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për:*KUVENDI KOMUNAL LIPJAN*

Për Aktivitetin e Prokurimit:*613-25-851-5-2-1*

Sa i përket tenderit për"Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan"

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Noi Construction shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Haxhi Kleqka, nr.99
(Adresa)
Lipjan — *14 000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
045 785 649 — *N/A*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Labinot Dedushi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
noiconstruction.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

02.01.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesësmund ta parashtroj kërkesënvetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit",nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate 19.02.2025 *Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 27.02.2025* *Dorezimi dhe hapja e tenderit 12.03.2025 14:00* *Njoftim mbi vendimi e AK 28.03.2025* *Leter standarde per tenderuesin e eleminuar 28.03.2025*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapje elektronike

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues gjate udheheqjes së ketij aktiviteti të prokurimit, nuk ka vepruar ne pajtim me nenet e meposhtme të LPP-së dhe RrPP-se: Nenin 7- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi; Nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tendereve; Nenin 69 - Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Te nderuar AK, ne perputhje me nenin 108/A te LPP-se, te pakenaqur me njoftimin mbi vendimin tuaj dhe brenda afatit te parapare ligjor i'u drejtohemi me kete kerkese per rishqyrtim te vendimit per dhenie te kontrates nje OE te pa pergjegjshem si dhe rishqyrtimin e eliminimit te ofertes tone. Pas pranimit te vendimit ne kemi bere menjeherekerkese per qasje ne dokumentacionin e OE te propozuar per shperblim me kontrate, dhe pas dhenies se qasjes se pjeserishme dhe analizimit te dokumentacionit teOE te propozuar per shperblim me kontrate, ju demtoni buxhetine KK Lipjan per 18,766.67 euro Gjithashtu na eshte mohuar e drejta per dokumentacionin zyrtare te OE te propozuar per shperblim me kontrate, ku kishim plotesisht te drejte ne baze te Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik - Neni 7 – Informatat sekrete afariste dhe qasja ne dokumentaion

Neni 7

Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion

7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

a. Informacionet në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP;
b. Informacionet në lidhje me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP.

7.6.1 Autoriteti Kontraktues nuk do të klasifikojë një informatë si sekret afarist, nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së tenderit me të gjitha informacionet e kërkuara në këtë formular, me theks të veçantë poqëse nuk i ka paraqitë të gjitha faktet dhe argumentet me

të cilat OE dëshmon se zbulimi i një informacioni do t'i shkaktojë dëm material biznesit të tij.

7.6.2 Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 "Njoftimi mbi vendimin e AK-së", duhet të përgatitë versionin e pastruar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 11 të LPP-së dhe të njoftojë palën.

7.6.3 Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

7.6.4 Me kërkesën me shkrim të një OJQ, e cila nuk është "palë e interesuar", siç përkufizohet ky term në paragrafin 1 nën paragrafin 1.26 të nenit 4 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës e cila kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 10 të LPP-së, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3 të nenit 10 të LPP-së, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur:

Po ashtu do ti faktojme arsyetimet lidhur me pergjegjshmerine e ofertes sone dhe konstatimete gabuara te komisionit vleresues te AK- se, te cilat kane derguar tek konsiderimi i tenderit tonë si të papergjegjshem.
Deshmia nga ana jone e pergjegjshmerise se ofertes sone me komplet dokumentacionin e bashkengjitur dhe kunder arsyetimeve te pabazuara dhe te kunderligishme te AK-seper refuzimin e tenderit tone, eshte si me poshte

Ne njoftimin mbi vendimin e AK-se dhe letren standarde per tenderuesin e eleminuar jane te dhena 4 arsye per refuzim te ofertes sone per aktivitetin e prokurimit ne fjale
Kerkesa 1 dhe 2

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. *Tek kerkesa 2, eshte kerkuar a) Min Nje inxhinier indertimtarise sistemi 5 vjeqar ose (master) drejtimi konstruktiv min 5 vite pervoje pune pas diplomimit, Inxhinieri juaj qe keni dorzuar ne kete dosje ka diplomuar ne vitin 2022 ne baze te diplomes se dozuar dhe nuk ka arritur 5 vite pervoj pune pas diplomimit.*

2. *Tek deshmia 2. eshte kerkuar Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes, ose parakontratat e punes me validitet dhe kohesgjatje te kete projekti. Juve keni dorzuar kontratat e punes per nje pjese te stafit te kerkuara jane 10 per puntoret kurse te dorzuara jane 7 kontrata, por duhet te ju njoftojme qe te gjitha kontratat e dorzuara te puntorve dhe nje pjese stafit profesional jane te mangeta dhe te pa plotesuara ne baze te ligjit te punes sepse ju mungojne fillimi dhe perfundimi i punes po ashtu nuk eshte e cekur ne kontrate edhe paga baze per secilin puntor apo staf te kompanise.*

Kerkesa 2 nga FDT.

Kerkesa 2. Lista e stafit a) Min Nje inxhinier i ndertimtarise sistemi 5 vjeqar	**Deshmia 2. Lista e stafit duhet te dorzohet e nenshkruar dhe e vulosur nga OE. a).Vendimi me shkrim mbi caktimin**

12

ose (master) drejtimi konstruktiv min 5 vite pervoje pune pas diplomimit, te caktohet si menaxher i projektit. b) Min Nje inxhinier i Elektroteknikes sistemi 5 vjeqar apo master min 5 vite pervoje pas diplomimit. c) Min Nje Gjeodet bachelor apo master dhe i licencuar, licence me afat, min 5 vite pervoj pune pas diplomimit. g) Min 10 puntor.	**e menaxherit per kete projekt i nenshkruar dhe vulosur nga OE b).Per stafin profesional te deshmohen me Diplome, CV dhe licenca e gjeodetit me afat, Per te gjith stafin kerkohen Kontratat e punes, ose parakontratat e punes me validitet dhe kohesgjatje te kete projekti. Per diplomat e fituara jashte Republikes se Kosoves kerkohen qe te jene te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosoves**

Deshmia, e kerkeses nr.1

REPUBLIKA E KOSOVËS
UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

REPUBLIC OF KOSOVO
UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË

FACULTY OF CIVIL ENGINEERING

Diplomë Diploma

HIVZI SAHIT KABASHI

U lind më 22.08.1981 në Istog.
U regjistrua në vitin akademik 2000/2001.
Studimet i mbaroi më 27 tetor 2006 në:
DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Born on 22.08.1981 in Istog.
Was enrolled in the academic year 2000/2001.
Completed his/her studies on 27 October 2006 in:
DEPARTMENT OF CONSTRUCTIONS

dhe mori titullin:
INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË

and was awarded the title:
DIPLOMA ENGINEER OF CIVIL ENGINEERING

Nivelli i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6
Nota mesatare gjatë studimeve 6,79
Nota e provimit të diplomës 9,00
Prishtinë, 9 mars 2022

Level of qualification according to the National Qualifications Framework: 6
Average grade of studies 6,79
Diploma examination grade 9,00
Prishtine, 9 March 2022

Nr.1264

Dekani / Dean
Prof. Ass. Dr. Florim Grajçevci

[redacted]

Rektori / Rector
Prof. Dr. Naser Sahiti

Per pretendimin nr.1 sqarim: kemi dorezuar Inxhinerin Hivzi Kabashi, me perfundim te studimeve 27.10.2006 por ka marr diplomen me 9 mars 2022, me qellim te vertetimit mund te ju drejtoheni me email Universitetit te Prishtines per te vertetuar daten e diplomimit te inxhinierit tone.
Viti i perfundimit te studimeve eshte perkatesisht 2006 dhe jo data kur eshte marr diploma 2022

Per pretendimin nr.2sqarim:kemi te gjitha kontratat me afat dhe paga te specifikara per secilen, si dhe parakontratat me stafin e angazhuar per projekt, ndersa ne dosje te tenderit te kerkesat nuk eshte cekur se duhet te jene kontratat me paga ose ndonje shume e cekur, por kontratat dhe parakontratat e paraqitura nga ne plotesojne kushtin e dosjes se tenderit dhe jane ne harmoni me ligjin e punes. Te gjitha kontratat dhe parakontratat jane valide ne emer te projektit deri ne perfundim te projektit.

Pretendimi nr.3 dhe 4

3. *Tek kerkesa 3, eshte kerkuar pika l) Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T =(min 1 cope), Juve keni dorzuar nje dokument Dud doganor per nje eskavator dhe te dhenat per eskavator dhe ne te jane te paraqitura edhe nje leter shtese me disa paisje ne ato paisje figurojn edhe do gersher per demolim betoni por nuk ploteson kerkesen e AK siq eshte kerkuar ne NJK dhe DT sepse kerkese e AK ka qene "Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T" deshmia e dorzuar eshte jashte kerkeses se AK.*

4. *Tek kerkesa 3, eshte kerkuar pika h) Eskavator max 1 T, per kete kerkese ju keni deshmur me dud doganor ne te cilin mungojn te dhenat per pronarin e paisjes, nuk ka asnje te dhene se kujna i perket kjo paisje ne dud doganor.*

Kerkesa 3 nga FDT

Kerkesa 3. Lista e pajisjeve teknike a) Eskavator min 20 T = (min 1 copë), b) Eskavator min 10 T = (min 1 cope), c) Eskavator me rrota gome min 20 T = (min 1 cope), d) Luge ngarkuese min 20 T = (min 1 copë), e) Luge ngarkuese max 2 T = (min 1 copë), f) Cilinder per ngjeshjen min 10 T = (min 2 cope), g) Cilinder per ngjeshjen max 3 T = (min 1 cope), h) Eskavator max 1 T = (min 1 cope) i) Greider min 15 T = (min 1 cope), j) Finisher min 6 T = (min 1 cope), k) Dumper max 5 T = (min 1 copë), l) Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T =(min 1 cope) m) Kamion auto kran = (min 1 cope), n) Auto Shporte = (min 1 cope), o) Kamion kiper = (min 3 copë)	**Deshmia 3. Lista e paisjeve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, per automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, Për automjetet qe regjistrohen Librezat e garkullimit me validitet. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve me deshmite sipas kerkeses me larte. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.**

Per pretendimin nr.3 sqarim: Per pretendimin nr.3 kerkesa juaj nuk ishte "Gersher per demolim betoni me prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T" eshte kerkuar te deshmohet me DUD apo Fature, ku ne kemi dorezuar dudin doganor me marreveshje nga Linda Shpk e cila posedon sipas dudit doganor Eskavator me gershere mbi 20 ton e cila eshte e mjaftueshme ne baze te kerkeses se FDTse. Ne baze te ligjit mund te na kerkonit informacion shtese, nese per ju ishte e nevojshme edhe pse ne e kemi plotesuar kete pike.

Per pretendimin nr.4sqarim: Per pretendimin nr.4 eshte kerkuar te deshmohet me DUD apo Fature, ku ne kemi dorezuar faturen e cila eshte e mjaftueshme ne baze te kerkeses se FDTse si dhe kemi dorezuar vetem fleten e dyte te DUD-it e cila eshte ne pronesi te Berisha Company . Ne baze te ligjit mund te na kerkonit informacion shtese, nese per ju ishte e nevojshme edhe pse ne e kemi plotesuar kete pike.

Duke u bazuar ne keto qe lartecekem, propozojme qe ju si AK te anuloni vendimin tuaj, te aprovoni kerkesen tone per rishqyrtim si te bazuar dhe te na shpallni si fitues ne kete procedure prokurimi, pasi i plotesojme te gjitha kerkesat e kerkuara ne dosjen e tenderit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demtimin e buxhetit te KK Lipjan per 18,766.67 euro
Refuzimi i ofertes sone si oferta e pergjegjshme dhe me çmimin me te ulet na privon nga mundesia per realizimin kontrates dhe profitit te planifikuar permes shkeljes se ligjit, i cili ndikon drejtperdrejt ne performancen financiare te kompanise dhe zhvillimin e metutjetshem te aftesive profesionale dhe teknike

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitnikërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

KUVENDI KOMUNAL LIPJAN

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan

Nr. i prokurimit [1]	**613-25-851-5-2-1**

Nr.	**Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik**	**Vlera totale e ofertës**
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik NOI CONSTRUCTION SH.P.K.; CONSTRUCTION GROUP SH.P.K.	289,037.47
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik MODELI INVEST GROUP SH.P.K.; Mali Art Group SH.P.K.	291,131.00
3.	AAB CONSTRUCTION SH.P.K. 810842668	283,165.57
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K.; R & Rukolli	307,804.14
5.	NIKA PrO- Ing SH.P.K. 811052307	312,315.95
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik Valdrini sh.p.k; IBRAHIM KURRUMELI B.I.; Benita Company	320,630.00
7.	AKTIV SH.P.K. 601250187	337,052.70

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna e Lipjanit, Drejtoria e Prokurimit **shpërblen** me kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K.; R & Rukolli Ferizaj, **me qmim 307,804.14**

Data: 28.03.2025

Emri dhe mbiemri i ZPP: Bekim Shabani

[1] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[1]

KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, SHQIPERIA 14000 LIPJAN
Data: 28.03.2025
Grup i Operatorëve Ekonomik BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K.; R & Rukolli, Ferizaj,

Nr i Prokurimit	**613-25-851-5-2-1**
Nr i brendshëm	

Titulli: Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan

I/e nderuar(a) **BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K.; R & Rukolli, Ferizaj,**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *[tenderin me çmimin më të ulët]* si përgjigje ndaj për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj me titull: **Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan me qmim** 307,804.14 euro dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Me respekt,

Bekim Shabani,
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm [1]

KUVENDI KOMUNAL LIPJAN, SHQIPERIA 14000 LIPJAN
Data: 28.03.2025
NIKA PrO- Ing SH.P.K. Rr.Rexhep Bislimi, Ferizaj

Nr i Prokurimit	**613-25-851-5-2-1**

Titulli: Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF - Lipjan

Te nderuar, NIKA PrO- Ing SH.P.K., Ferizaj

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj *[nuk qe më i favorshmi nga aspekti ekonomik]* *[nuk qe tenderi me çmimin më të ulët]* në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.
